

**L I G J**  
**Nr.7776, datë 22.12.1993**

**PËR BUXHETIN LOKAL**

***I azhurnuar me:***

*Ligjin Nr.8399, datë 09.09.1998*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Buxheti lokal është programi kryesor financiar vjetor i organit të pushtetit lokal. Në të përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e përcaktuara me ligj për kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e kompetencave që ka organi i pushtetit lokal në territorin ku vepron.

Çdo organ i pushtetit lokal ka buxhetin e vet. Buxheti lokal është unik dhe përbëhet nga pjesa e buxhetit të pavarur dhe pjesa e buxhetit të shtetit.

**Neni 2**

Pjesa e buxhetit lokal të pavarur përbëhet nga të ardhurat dhe shpenzimet që, në përputhje me dispozitat ligjore, përfshihen në buxhetin e organeve të pushtetit lokal. Këshillat e organeve të pushtetit lokal janë organet e vetme që, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, kanë kompetencë të vendosin për hartimin, miratimin dhe zbatimin e kësaj pjese të buxhetit.

**Neni 3**

Pjesa e buxhetit lokal të kushtëzuar përfshin pjesën e fondeve të buxhetit qendror që derdhet në buxhetin e komunës, bashkisë e rrethit për t'u përdorur në destinacion të caktuar dhe që vetëm administrohet prej organeve të pushtetit lokal.

Këshillat e organeve të pushtetit lokal nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin fillestar të fondeve të buxhetit të shtetit.

**Neni 4**

Viti buxhetor për pushtetin lokal fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

**Neni 5**

Klasifikimi i buxhetit lokal në tituj, kapituj e artikuj bëhet nga Ministria e Financave.

Struktura e buxhetit lokal përcaktohet nga Këshilli i komunës, bashkisë dhe rrethit.

### **Neni 6**

Të ardhurat e buxhetit lokal të pavarur formohen nga:

- a) të ardhurat nga burimet e brendshme lokale, në të cilat përfshihen:
- të ardhurat nga pjesa e taksave dhe tatimeve nacionale që me ligj derdhen drejtpërdrejt në favor të organeve të pushtetit lokal;
  - të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë që me ligj u lihen organeve të pushtetit lokal;
  - të ardhurat nga taksat lokale;
  - të ardhurat nga tarifat e shërbimeve;
  - të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike në vartësi të pushtetit lokal, shpenzimet e të cilave financohen nga buxheti lokal i pavarur;
  - të ardhurat nga gjambat, në zbatim të kompetencave të organeve të pushtetit lokal, si dhe nga të gjitha gjambat e tjera, kur këto u lihen sipas dispozitave ligjore organeve të pushtetit lokal;
  - të ardhurat nga interesat aktive;
- b) të ardhurat nga ndihmat dhe kreditë, në të cilat përfshihen:
- të ardhurat nga ndihmat e organizatave humanitare dhe ato që përfitohen nga marrëdhëniet që vendosen ndërmjet organeve të pushtetit lokal dhe homologëve të tyre brenda dhe jashtë vendit;
  - kreditë vetëm për investime, në përputhje me dispozitat ligjore;
  - të ardhurat nga dhurime dhe sponsorizime të ndryshme;
- c) të ardhurat nga buxheti i shteti, të cilat përcaktohen sipas ligjit vjetor të buxhetit të shtetit.

### **Neni 7**

Në shpenzimet e buxhetit lokal të pavarur përfshihen:

- Shpenzime për realizimin e funksioneve administrtrive dhe shërbimeve publike lokale;
- shpenzime për investime;
- shpenzime për shërbimin e kësteve të kredisë dhe interesave pasive;
- krijimi i fondit rezervë.

### **Neni 8**

Për të përballuar shpenzimet e paparishikuara në buxhetin lokal, krijohet fondi rezervë në masën jo më shumë se 3 përqind të totalit të shpenzimeve.

### **Neni 9**

Buxheti lokal nuk parashikohet me deficit. Ai është i balancuar.

## **KREU II**

### **HARTIMI DHE MIRATIMI I BUXHETIT LOKAL**

### **Neni 10**

Projektbuxheti lokal hartohet nga çdo komunë, bashki e rreth dhe miratohet nga këshilli përkatës.

### **Neni 11**

Projektbuxheti për organet e pushtetit lokal paraqitet në prefekturë dhe në degën e buxhetit të rrethit, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Prefektura, pasi i shqyrton nga pikëpamja procedurale e teknike projektbuxhetet e organeve të pushtetit lokal të juridiksionit të saj, ia dërgon Ministrisë së Pushtetit Lokal, e cila ia paraqet

pastaj Ministrisë së Financave.

#### **Neni 12**

Nëse deri në fund të vitit buxhetor këshilli përkatës nuk miraton buxhetin lokal të pavarur, me fillimin e vitit të ri buxhetor vazhdojnë të përdoren për çdo muaj të ardhurat dhe shpenzimet në masën sa 1/12 e treguesve të miratuar në vitin e mëparshëm buxhetor.

#### **Neni 13**

Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal përgatit udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore, të nevojshme për hartimin e projektbuxhetit lokal dhe udhëheq procesin e hartimit të këtij buxheti.

### **KREU III ZBATIMI I BUXHETIT LOKAL**

#### **Neni 14**

Buxheti lokal zbatohet nga kryetari i këshillit të rrethit, kryetari i bashkisë, kryetari i komunës dhe administrara e tij, sipas vendimit të këshillit përkatës.

#### **Neni 15**

Urdhëruesit kryesorë të fondeve të buxhetit lokal janë:

- për komunën: kryetari i komunës
- për bashkinë: kryetari i bashkisë
- për rrethin: kryetari i këshillit të rrethit

Urdhëruesit e shkallës së dytë dhe të tretë, në përputhje me dispozitat ligjore, janë drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike lokale, në rast se autorizohen nga urdhëruesit kryesorë.

#### **Neni 16**

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e buxheteve të organeve të pushtetit lokal regjistrohen nëpërmjet llogarive të institucioneve, të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe kontrollohen, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Shërbimi i arkës për buxhetin lokal kryhet nga banka e autorizuar nga Drejtoria e Thesarit.

#### **Neni 17**

Kontrolli i buxhetit lokal në organet e pushtetit lokal kryhet rregullisht jo më pak se një herë në vit nga prefektura dhe organet e ngarkuara nga këshillat përkatës.

Kontrolli i buxhetit të pushtetit lokal kryhet edhe nga organet e caktuara me ligj, si Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit

#### **Neni 18**

Këshillat lokalë gjatë vitit buxhetor, mund të vendosin për ndryshime në treguesit e buxhetit lokal të pavarur dhe të propozojnë ndryshime të treguesve të buxhetit të shtetit.

#### **Neni 19**

Këshilli i komunës, bashkisë dhe rrethit është i vetmi organ që ka të drejtë të transferojë fondet falas ose me të drejtë kthimi, për t'ia kaluar organeve homologe, nga të ardhurat nga burimet e brendshme të buxhetit të pavarur lokal.

#### **Neni 20**

Ministria e Financave, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, kur gjykohet e nevojshme gjatë vitit buxhetor, mund të transferojë fondet e buxhetit të shtetit (që bëjnë pjesë në buxhetin lokal të organit të pushtetit lokal) në një organ tjetër të pushtetit lokal, pasi të jetë marrë më parë miratimi i këshillit të organit të pushtetit lokal që disponon fondet.

#### **Neni 21**

Nëse të ardhurat nga burimet lokale ose çdo e ardhur tjetër, duke përfshirë edhe ato të buxheti qëndror, janë më të larta se ato të parashikuara në buxhet, atëherë këshilli përkatës mund t'i rritë shpenzimet në buxhetin lokal të pavarur.

Nëse të ardhurat nga burime të brendshme lokale ose të ardhura të tjera janë më të ulëta se ato të parashikuara në buxhet, atëherë shpenzimet duhet të pakësohen në të njëjtën masë. Shtesa e fondeve nga buxheti qëndror bëhet vetëm me miratim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 22**

Fondet e buxhetit lokal, të përmendura në nenin 6, pikat "a" dhe "b", të përdorura gjatë vitit buxhetor, mbarten në vitin e ardhshëm buxhetor. Fondet buxhetore me destinacion të përdorura gjatë vitit nga organet e pushtetit lokal, kalojnë në favor të shtetit.

#### **Neni 23**

Çdo urdhërues buxhetor detyrohet të marrë masat e nevojshme, që sigurojnë realizimin e buxhetit, sipas strukturave dhe klasifikimit buxhetor. Periodikisht dhe në fund të vitit buxhetor urdhëruesit kryesorë i raportojnë këshillave përkatës të organeve të pushtetit lokal për zbatimin e buxhetit të tyre përkatësisht në komunë, bashki e rreth. Gjithashtu, ata i raportojnë prefekturës, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Financave për fondet e dhëna nga buxheti i shtetit.

#### **Neni 24**

Urdhëruesit buxhetorë dhe punonjësit e ngarkuar me zbatimin e buxhetit në organet e pushtetit lokal, mbajnë përgjegjësi për realizimin me korrektësi të buxhetit lokal dhe respektimin e afateve të caktuara nga ky ligj dhe aktet përkatëse nënligjore. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

1. Mosrespektimi i afateve, procedurave dhe kushteve të parashikuara sipas neneve 11 dhe 16.
2. Përdorimi i fondeve në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenet 18 dhe 23.

#### **Neni 24/1**

Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 24, përveç shpërblimit të dëmit të shkaktuar, ndaj kundërvajtësve jepet dënim administrativ me gjobë nga 5 mijë lekë deri në 50 000 lekë.

Dënimi administrativ me gjobë vendoset nga organet e kontrollit të parashikuara në nenin 17.

Procedurat, afatet dhe mënyra e konstatimit, të shqyrtimit, të ankimit dhe të ekzekutimit të dënimeve administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative.

#### **Neni 25**

Këshilli i komunës, i bashkisë dhe i rrethit, pasi shqyrtojnë zbatimin e buxhetit të tyre, miratojnë buxhetin faktik dhe, brenda datës 15 mars, e depozitojnë pranë prefekturës përkatëse.

Ministria e Pushtetit Lokal dërgon brenda muajit prill në Ministrinë e Financave buxhetet faktike të të gjitha organeve të pushtetit lokal.

#### **Neni 26**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji..

#### **Neni 27**

Dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.7616 , datë 30.9.1992, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.266, datë 22.7.1992 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

#### **Neni 28**

Zbatimi i procedurave sipas këtij ligji fillon gjatë vitit 1994. Procedurat e parashikuara në këtë ligj përjashtohen për vitin 1993.

#### **Neni 29**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.746, datë 6.1.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**

Perdite.org dhe Digitalizuar nga  
Qendra per Qeshtjet e Informimit Publik,  
INFOÇIP  
www.infocip.org  
www.vendime.al